

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Valdete Daka dhe Agim Maliqi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarve A.T., nga fshati D., komuna e Gj. dhe Sh.P., nga fshati B., komuna e Gj., për shkak të veprës penale privimi i kundërligjshëm i lirisë, nga neni 196 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit A.T., av. Sevdail Robelli, ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA.1.nr.1030/2017, të datës 23.1.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 30 prill 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit A.T. kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA.1.nr.1030/2017 të datës 23.1.2018.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.134/2017 e datës 3.8.2017, të dënuarit A.T. dhe Sh.P., janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale, të kryer në bashkë ekzekutim, privimi i kundërligjshëm i lirisë, nga neni 196 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK dhe për këtë vepër penale janë gjykuar secili veç e veç me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muajve, të cilin dënim të dënuarit nuk do ta mbajnë, nëse në afat prej 1 (një) viti nga plotfuqishmëria e aktgjykimit nuk kryejnë ndonjë vepër tjetër penale. Të dëmtuarat për realizmin e kërkesës pasurore-juridike janë udhëzuar në kontest civil. Të dënuarit janë obliguar që t'i paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësor secili në shumë prej nga 20 €, e në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin PA.1.nr.1030/2017 e datës 23.1.2018, ka aprovuar ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore Gjilan, ashtu që aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka ndryshuar

vetëm përkitazi me vendimin për dënim, ashtu që të dënuarit A.T. dhe Sh.P. për veprën penale privimi i kundërligjshëm i lirisë nga neni 196 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK, për të cilën janë shpallur fajtor i ka gjykuar secilin veç e veç me dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga 6 (gjashtë) muaj.

Kundër aktgjykimit të shkallës së dytë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të dënuarit A.T., av. Sevdail Robelli, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe për shkak të shkeljes së ligjit penal me propozim që aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të ndryshohet dhe ta lë në fuqi aktgjykimin e Gjykatës Themelore ose ta anulojë aktgjykimin e shkallës së dytë dhe çështjen ta kthejë në rigjykim si dhe të shtyhet ekzekutimi i dënimit deri sa të vendoset në mënyrë meritore nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Prokurori i Shtetit me parashtresën, KMLP.II.nr.57/2018 e datës 27.3.2018, ka propozuar që të refuzohet si e pabazë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit A.T.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes e në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mbrojtësi i të dënuarit, av. Sevdail Robelli pretendon se aktgjykimi i shkallës së dytë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e duke mos i precizuar shkeljet e pretenduara por nga referati i kërkesës rrjedhë se kemi të bëjmë me shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.12 të KPPK. Kjo shkelje konsiston në faktin se gjykata e shkallës së dytë me rastin e shqiptimit të dënimit për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i dënuari nuk ka dhënë arsyetim lidhur me vlerësimin e rrethanave rënduese të cilat kanë ndikuar që të dënuarit A.T. t'i ndryshohet vendimi mbi dënimin dhe t'i shqiptohet dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve. Po ashtu, pretendohet se gabimisht Gjykata e Apelit si rrethanë rënduese e ka marrë faktin se vepra është kryer me dashje dhe me vetëdije të plotë që përbënë shkelje të ligjit penal dhe atë konkretisht të nenit 73 të KPK si dhe është shkelur dispozita e nenit 76 par.1 nënpar.1.7 e cila dispozitë parasheh që në rast se për vepër penale nuk është paraparë minimumi i dënimit, atëherë mund të shqiptohet dënim me gjobë në vend të dënimit me burgim. Më tutje mbrojtësi pretendon se ndaj të dënuarit është shkelur edhe dispozita e nenit 47 të KPK sepse sipas kësaj dispozite kur gjykata shqipton dënim me burgim deri në 6 (gjashtë) muaj ajo me pëlqimin e palës mund ta zëvendësojë këtë dënim me dënim me gjobë. Të gjitha këto shkelje kanë bërë që ndaj të dënuarit t'i shkelet ligji penal në dëm të tij.

Gjykata Supreme duke vlerësuar pretendimet e potencuara në kërkesë gjen se aktgjykimi i shkallës së dytë nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse në arsyetimin e dhënë lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

të shqiptuar ndaj të dënuarit vlerësohen rrethanat lehtësuese nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe rrethanat rënduese të cilat kanë ekzistuar në rastin konkret e duke gjetur se i dënuari veprën penale e ka kryer me dashje e me vetëdije të plotë rrethanë kjo e cila është e paraparë me nenin 74 par.2 pika 2.2 të KPK, dhe për këtë jep arsyetim ligjor të cilin si të drejtë e pranon edhe kjo gjykatë, gjë që e bënë pretendimin të paqëndrueshëm.

Sa i përket pretendimeve për shkeljen e ligjit penal kjo gjykatë po ashtu gjen se këto pretendime nuk qëndrojnë sepse është e vërtetë se sipas dispozitës së nenit 76 par.1 pika 1.7 të KPK, nëse për veprën penale nuk është paraparë masa më e ulët e dënimit atëherë mund të shqiptohet dënimi me gjobë në vend të dënimit me burgim dhe në rastin konkret kemi të bëjmë me veprën penale privimi i kundërligjshëm i lirisë nga neni 196 par.1 të KPK, ku për këtë vepër penale është paraparë që dënimi të jetë dënim me gjobë ose me burgim deri në 3 (tre) vjet, pra nuk është i paraparë minimumi ligjor për këtë vepër penale. Mirëpo gjykata e ka në diskrecion të saj që të vendos lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit të shqiptuar. Kjo nga fakti se dispozita e nenit 76 par.1 pika 1.7 të KPK, nuk e parasheh se shprehimisht duhet të shqiptohet dënimi me gjobë në vend të dënimit me burgim, por këtë e lë si mundësi, gjë që edhe gjykata e shkallës së dytë edhe ka vendosur dhe i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit të shqiptuar.

Po ashtu, nuk qëndron as pretendimi se është shkelur dispozita e nenit 47 të KPK, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk e ka mundësinë që të bëjë zëvendësimin e dënimit me burg me dënim me gjobë ngase kjo mundësi është vetëm para gjykatës së shkallës së parë dhe vetëm në prezencën e të dënuarit i cili edhe duhet të jep pëlqimin për këtë. Meqenëse në rastin konkret gjykata e shkallës së dytë nuk ka hap seancën por vetëm ka vendosur sipas ankesave të palëve, pra si gjykatë e shkallës së dytë, andaj edhe nuk ka pasur obligim që ta kërkojë pëlqimin për zëvendësim e as që ka pasur mundësinë ligjore që ta bëjë këtë zëvendësim.

Nga të gjitha këto që u thanë më lartë e duke mos gjet shkelje të ligjit penal në dëm të të dënuarit kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë u konsiderua si e pabazuar dhe konform nenit 437 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr.79/2018, më 30 prill 2018

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Nesrin Lushta